

William R. Hite, Jr., Ed.D.

Superintendent

28 Tetor 2021

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Po ju shkruaj me një përditësim të rëndësishëm për planet tona të gatishmërisë në qoftë se një marrëveshje e re nuk është arritur në mes Union të Punëtorëve të Transportit Lokal 234 dhe SEPTA nga e Diela, 31 Tetor dhe një grevë SEPTA mund të ndodhë sa më shpejt që të Hënën, 1 Nëntor. Kjo nuk do të thotë se do të ndodhë një grevë. Ndërsa SEPTA është optimiste se negociatat do të vazhdojnë dhe do të arrihet një marrëveshje, ne duam të ndajmë planet tona në rast se ka një ndërprerje të shërbimit.

Funksionet e shkollave

Të gjitha shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (SDP) do të qëndrojnë të hapura për mësimin në person në këtë kohë. Ndjekja e shkollës në person u siguron të rinjve tanë rutinat e njohura, ndjenjën e komunitetit dhe shërbimet mbështetëse që u nevojiten për mirëqenien e tyre sociale, emocionale dhe akademike. Tani më shumë se kurrë, shkollat tona janë strehë e sigurt për mijëra nxënës që po përjetojnë ndikimet reale të rritjes së dhunës me armë dhe traumave të tjera që ndikojnë në komunitetet tona.

Zyrat e Drejtorisë

Të gjitha zyrat e SDP-së, përfshirë ato në 440 N. Broad Street, do të funksionojnë sipas orareve të tyre normale.

Stafi i shkollës

Sigurimi i funksionimit të sigurt dhe të rregullt të shkollës është prioriteti ynë kryesor. Raportet e hershme tregojnë se shumica e punonjësve tanë, madje edhe ata që mbështeten në SEPTA, do të jenë në gjendje të raportojnë në punë në mënyrë që shkollat dhe zyrat tona të mbeten të hapura për studentët dhe familjet tona. Janë duke u zhvilluar plane për të monitoruar personelin në çdo shkollë çdo ditë dhe për të vendosur mbështetje nga stafi i edukatorëve dhe Zyrës Qendrore për shkolla specifike që mund të kenë nevojë për mbulim shtesë.

Shërbimet e Transportit

Studentët që aktualisht janë caktuar në një autobus ose furgon do të vazhdojnë të marrin shërbime transporti. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës kombëtare të shoferëve që tashmë po ndërpret operacionet e Drejtorisë tonë, ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë transport për studentët që nuk janë caktuar aktualisht në një itinerar. Familjet mund të presin vonesa të autobuzave për marrjen dhe kthimin e studentëve pasi parashikohen më shumë automjete në rrugë në rast të një greve të SEPTA. Ne kërkojmë durimin tuaj paraprakisht sepse shoferat tanë kanë prioritet

sigurinë e studentëve dhe të tjerëve në rrugë. Për pyetje në lidhje me autobuzin ose furgonin e fëmijës tuaj gjatë gjithë ditës, ju lutemi telefononi 215-400-4350.

Frekuentimi i studentëve

Ne presim që të gjithë studentët të vazhdojnë të ndjekin shkollën në person gjatë gjithë ditës dhe çdo ditë, si një pjesë jetike e mirëqenies së tyre sociale, emocionale dhe akademike. Studentët, të cilët nuk mund të ndjekin shkollën në person gjatë grevës SEPTA pritet të hyjnë në Google Classroom, ose Canvas për detyrat e tyre dhe do të angazhohen në mësim asinkron çdo ditë (i pavarur). Ju mund të përdorni këto hapa të dobishme [How to Log Into Google Classroom](#) nëse është e nevojshme dhe lidhuni me shkollën e fëmijës suaj për mbështetje shtesë që mund të jenë të disponueshme. Mos regjistrimi i përditshëm dhe mos kryerja e detyrave në kohë do të rezultojë në një mungesë të pajustificuar. Mësimi hibrid nuk do të ofrohet dhe studentët nuk do të mund të hyjnë virtualisht në klasat e tyre.

Ushqimi Studentëve

Të gjithë studentët do të vazhdojnë të kenë akses në ushqime falas, të besueshme dhe ushqyese çdo ditë shkollore. Vaktet e mëngjesit dhe të drekës do të vazhdojnë të shërbehen për të gjithë nxënësit që ndjekin shkollën në person. Duke filluar nga e Mërkura, 3 Nëntor familjet e nxënësve të regjistruar, të cilët nuk mund të ndjekin shkollën në person për shkak të grevës SEPTA do të marrin vaktet e ushqimeve çdo javë në një nga 12 vendet/shkollat e shpërndarjes në të gjithë qytetin. Kompletet e vakteve do të përmbajnë pesë(5) mëngjese dhe pesë(5) dreka që mund të mbahen në frigorifer derisa studentët të jenë gati për t'i ngrohur dhe për t'i ngrënë. Lista e vendeve të shpërndarjes, të cilat do të funksionojnë çdo të Mërkurë nga ora 9:00 deri në orën 10:00 dhe 13:00 deri në orën 14:00, mund të gjenden në philasd.org/septastrike. Meqenëse Drejtoria duhet të mbajë të dhëna të detajuara për shpërndarjen e vakteve, familjet do të duhet të japin emrin e fëmijës së tyre, shkollën dhe numrin e ID-së në mënyrë që të marrin paketat e tyre të vakteve javore.

Pajisjet Chromebook dhe Interneti

Nëse Chromebook i fëmijës suaj nuk funksionon ose ka nevojë për riparim, kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj për një zëvendësim ose vizitoni këtë faqe [Chromebook Support Webpage](#) për informacion rreth qendrave tona të mbështetjes teknike dhe linjave telefonike. Ju gjithashtu mund të vizitoni [Internet Access Options for Families](#) nëse keni nevojë për informacione për shërbimet e internetit pa kosto ose me kosto të ulët.

Programet Para dhe Mbas Shkollës

Të gjitha programet para dhe mbas shkollës do të vazhdojnë siç janë planifikuar në këtë kohë. Ju lutemi kontaktoni shkollën e fëmijës suaj për çdo pyetje specifike.

Atletikë


Informacion shtesë do të jepet për sezonin e sporteve dimërore, i cili fillon më 19 Nëntor, nëse në atë kohë është duke u zhvilluar greva SEPTA.

Ky dhe më shumë informacion rreth planeve tona të gatishmërisë mund të gjenden në philasd.org/septastrike. Ne do t'ju ofrojmë një tjetër përditësim mbi statusin e negociatave dhe çdo hollësi shtesë mbi planet tona të Dielën, 31 Tetor. Ju gjithashtu mund të merrni informacione

të përditësuar duke vizituar septa.org dhe websajtin e qytetit të Filadelfias në phila.gov, duke dëgjuar KYW Newsradio 1060 AM, ose duke telefonuar linjën telefonike HOTLINE të Drejtorisë Arsimore në 215-400-INFO.

Pa dyshim që ky vit shkollor ka pasur vështirësitë e veta dhe mundësia e një greve të SEPTA-s është një tjetër që ne do ta kalojmë së bashku. Nëse ndodh një grevë, ju lutemi dini se kujdesi për nevojat e nxënësve, familjeve dhe stafit tonë është prioriteti ynë më i lartë, siç ka qenë gjatë gjithë kësaj pandemie.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias